




Pranuar / Dorezuar Priliceno/Prodato Received/Deliverty	12.04.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shturim Fisqy Appendis	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	3488	2023	1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 431/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 431/2023 të datës 28.02.2023 të parashtruar nga ankuesi . kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, ne çështjen juridike „kontestim konkursi”, në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 431/2023 të datës 28.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi . më datë 28.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2152/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me 179/23 të datës 06.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Departamentit për Menaxhimin e Zyrtare Publike. Ndërsa Këshilli, me datë 21.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 02.11.2022 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencës: RN00010341 për grupin "*Specialistë i Shkencave Shoqërore*" lidhur me pozitën *Inspektor i Arsimit*, në kuadër të Inspektoratit të Arsimit. Në këtë konkurs ka aplikuar ankuesi të cilit përmes Vendimit me Nr. 179/2023 të datës 06.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i është refuzuar aplikacioni për shkak se i njëjti nuk ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara me konkurs. Ankuesi më datë 28.02.2023 ka parashtruar ankesë ndaj këtij vendimi, ndërsa Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes Vendimit me Nr. 179/2023 të datës 06.01.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 179/2023 të datës 06.01.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtare Publike, kërkon që ky vendim të anulohet.

Në bazë të provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se më datë 15.02.2023 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, përmes njoftimit ka bërë anulimin e konkursit me numër të referencës RN00010341 për emrin e grupit "*Specialist të Shkencave Shoqërore*", pa ndonjë arsye konkrete, ndërsa më datë 27.02.2023 përmes e-mailit zyrtar kemi kërkuar nga Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë e Punëve të Brendshme arsyetim të saktë se mbi çfarë baze dhe arsye është anuluar konkursi, kurse më datë 03.03.2023 përmes e-mailit kemi pranuar informatën nga Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë i Ministrisë e Punëve të Brendshme si: "*Sipas kërkesës suaj, ju njoftojmë se anulimi i konkursit për grupin Specialist të Shkencave Shoqërore....., ka ndodhur për shkak të gabimeve përmbytësore në kriteret e konkursit, për këtë arsye është parë e nevojshme të anulohet kjo procedurë*".

Në bazë të konkursit me numër të referencës RN00010341 për emrin e grupit "*Specialist të Shkencave Shoqërore*", lidhur me pozitën "*Inspektor i Arsimit*" në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektorati i Arsimit të Kosovës të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë si në vijim:

- *Kualifikime/trajnime të posaçme nga fusha përkatëse profesionale;*
- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve themelore dhe postdiplomike 300 kredi/ECTS, (MA, MSC, MR) në fushën arsimore ose juridike;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën arsimore ose juridike;*
- *Te mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit dhe*
- *Të mos jetë i dënuar.*

Meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me këtë proces ka pranuar disa ankesa, ka shqyrtuar në mënyrë të hollësishme të gjithë procesin ndërsa me Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023, ka refuzuar ankesën me numër A.nr.399/2023 të datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi/kandidati A.H, dhe ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 15.02.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme për anulimin e këtij konkursi.

Në Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale në këtë procedurë duke filluar nga kriteret e konkursit që janë të specifikuar si më lartë dhe është vlerësuar që kriteret e konkursit kanë qenë në kundërshtim me rregullativen ligjore në fuqi, respektivisht me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili është ligj bazik për themelimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil konkretisht shtojcën Nr.2, Kodi i grupit 14. Gr. që përcaktojnë fushës e kërkuar e arsimit për këtë grup, shtojcën Nr.1/8 lidhur përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën Profesional 1 respektivisht me kërkesat e përgjithshme formale ku në pikën a) *kërkohet arsimimi*, ndërsa në pikën c) *përvoja e punës së kërkuar*.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e ankesës së ankueses dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të tij konstaton se duke marr për bazë Vendimin me numër A.nr.399/2023 të datës 15.03.2023 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes të cilit ka evidentuar shkeljet në këtë proces dhe ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 15.02.2023 i nxjerrë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme për anulimin e këtij konkursit, atëherë çdo vazhdim tutje i këtij procesi do të rezultonte edhe me shkelje më të mëdha procedurale dhe materiale.

Nga theksimet si me lartë Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet e ankuesit që të anulohet Vendimi me Nr. 179/2023 i datës 06.01.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe rasti të kthehet në rishqyrtim, janë të pamundura ngase nuk kanë objekt shqyrtimi, andaj në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të inicuar sipas ankesës me numër A.nr.346/2023 të datës 10.02.2023 të parashtruar nga ankuesi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.431/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

Ankuesit

Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB dhe;

Arkivit të KPMSHCK-së;